

VENDIM
Nr. 462, datë 30.7.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 421, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE, DOKUMENTACIONIN, AFATET E SHQYRTIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA TË LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE TË LEJUARA ME ARMËT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I, pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Policia e Shtetit bën licencimin e veprimtarisë së personave fizikë e juridikë në fushën e veprimtarisë së lejuar me armët, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar.

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) pranë Ministrisë së Mbrojtjes kryen licencimin e veprimtarisë, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar.”.

2. Në kreun II, pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Për t’u pajisur me licencë për veprimtaritë e lejuara me armë, personi fizik/tregtari i pajisur me NUIS dhe personi juridik i pajisur me NUIS, për secilën nga licencat e përcaktuara në shkronjat “b” deri në “dh”, të pikës 1, të nenit 14, dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, këto dokumente:

a) Kërkesën për licencë;

b) Vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore” të personit fizik ose të administratorit të personit juridik, vërtetim nga gjykata që shoqëria nuk është në proces gjyqësor/nuk është dënuar dhe nga prokuroria që shoqëria nuk është në procedim penal;

c) Letërnjoftim/pasaportë, të njohur sipas legjislacionit në fuqi të personit fizik ose të administratorit të personit juridik;

ç) Kontratë pune me drejtuesin teknik;

d) Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët për personin fizik, për pronarët përfitues të personit juridik, sipas përcaktimit të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, drejtuesin teknik, si dhe personat e punësuar, veprimtaria e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike.

3.1 Personi fizik ose juridik dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*:

a) për personin e punësuar, i cili kryen në këtë subjekt një procedurë pune, që lidhet drejtpërdrejt me armët, dokumentet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d”, të pikës 3, të këtij kreu, dëshminë e aftësisë teorik e praktik për përdorimin e armës, si dhe trajnimet specifike, sipas pozicionit të punës së punonjësit; si dhe

b) në rastet e personave juridikë, dokumentin e parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 3, për pronarët përfitues.

3.2 Dokumentet e përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 3, të këtij kreu, dëshmia e aftësimit teorik dhe praktik për përdorimin e armës, si dhe trajnimet specifike të punonjësit dërgohen edhe fizikisht nëpërmjet postës së porositur në komisaratin e policisë, ku ka vendin e ushtrimit të aktivitetit ose selinë qendrore subjekti, i cili kërkon të pajiset me licencë për veprimtaritë e lejuara me armët, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga paraqitja në formë elektronike e kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, sipas përcaktimeve të mësipërme.

3.3 Subjekti juridik, që paraqet kërkesë për t’u pajisur me licencë për aftësimin teorik e praktik për përdorimin e armëve, dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, kontratën me subjektin e licencuar për poligon qitjeje të mbyllur, të hapur ose me pjatel, për një afat të paktën 5 (pesë) vjet. Në rastet e ndryshimit të kontraktorit të licencuar për poligon qitjeje, titullari i licencës njofton Komisionin e Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL), në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në këtë rast aplikohet një afat pezullimi i aktivitetit deri në lidhjen e kontratës së re, me afat periudhën e mbetur të licencës nga momenti i hyrjes në fuqi të kontratës së re me subjektin e licencuar për poligon qitjeje të mbyllur, të hapur ose me pjatel.

3.4 Përgjithësisht, kur, për shkaqe teknike, kërkuessit e kanë të pamundur paraqitjen e kërkesës në formë elektronike nëpërmjet portalit *e-Albania*, kërkesa paraqitet drejtpërdrejt në zyrat e komisaratis të policisë, ku ka vendin e ushtrimit të aktivitetit ose selinë qendrore subjekti ose nëpërmjet postës së porositur.”.

3. Në kreun III, pikat 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për licencim nga strukturat përkatëse të policisë ndiqet kjo procedurë:

a) Struktura përgjegjëse e ngarkuar me detyrën e pranimit të dokumenteve verifikon dokumentacionin e dërguar nga personi fizik/juridik, si dhe plotësimin e formularëve përkatës sipas rubrikave;

b) Struktura përgjegjëse verifikon besueshmërinë e kërkuessit, përfshirë hetimin për rastet e pastrimit të parave apo financimin e terrorizmit dhe përgatit dokumentin e besueshmërisë e të përshtatshmërisë së personit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve;

c) Struktura përgjegjëse inspekton në vend objektin e verifikon kushtet teknike dhe të sigurisë në ambientet e punës e të atyre në vendet e ruajtjes, përfshirë masat dhe kushtet e sigurisë në mjetet e transportit të armëve dhe municioneve. Pas verifikimit, përpilon raportin përkatës nëse objekti i plotëson kushtet apo jo, sipas përcaktimeve në rregulloren në fuqi për kushtet e rregullat e sigurisë së armëve;

ç) Struktura përkatëse në drejtorinë vendore të policisë verifikon dokumentacionin e ardhur nga komisarariatet e policisë për subjektet që kanë paraqitur kërkesë për pajisje me licencë në fushën e veprimtarisë me armët dhe, pasi bën vlerësimin e tij, ia përcjell Departamentit për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

d) Struktura përkatëse në Departamentin për Sigurinë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit verifikon dokumentacionin e ardhur për subjektet që kanë paraqitur kërkesë për pajisje me licencë në fushën e veprimtarisë me armët të subjekteve për veprimtaritë e lejuara me armët dhe ia paraqet për shqyrtim Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL);

dh) Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL) mblidhet çdo muaj, shqyrton dokumentacionin e grumbulluar për pajisjen me licencë dhe merr vendim për miratimin/refuzimin e licencës.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mban Regjistrin e Licencave dhe Autorizimeve për Veprimtaritë e Lejuara me Armët. Struktura përgjegjëse regjistron vendimin e miratimit ose të refuzimit të kërkesës për licencim, si dhe çdo vendim miratimi apo refuzimi të kërkesave të mëparshme për licencim, sipas rastit. Licenca dhe çdo vendim lidhur me licencat e lëshuara dërgohen për publikim në Regjistrin Kombëtar të Licencave, që administrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

6. Refuzimi i dhënies së licencës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL). Në çdo rast, vendimi i refuzimit të dhënies së licencës arsyetohet në përputhje me përcaktimet e neneve 99 e 100 të Kodit të Procedurës Administrative. Kërkuesit i dërgohet vendimi në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete, me të cilat është paraqitur kërkesa.

7. Kërkesa për ripërtëritje të licencës bëhet 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të afatit të licencës që ka në përdorim personi fizik ose juridik. Personi fizik/juridik dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, këto dokumente:

- a) Kërkesë për licencë;
- b) Vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore” të personit fizik ose të administratorit të personit juridik, vërtetim nga gjykata që shoqëria nuk është në proces gjyqësor dhe nga prokuroria që shoqëria nuk është në procedim penal;
- c) Letërnjoftim/pasaportë të njohur sipas legjislacionit në fuqi të personit fizik/administratorit të personit juridik;
- ç) Kontratë pune me drejtuesin teknik;
- d) Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, për personin fizik, për pronarët përfitues të personit juridik, sipas përcaktimit të ligjit nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, drejtuesin teknik, si dhe personat e punësuar, veprimtaria e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me armët, sipas udhëzimit në fuqi për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët, lëshuar nga autoriteti përkatës brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike.

7.1 Personi fizik ose juridik dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*:

- a) në rastet e personave juridikë, dokumentin e parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 3, të kreut II, për pronarët përfitues;
- b) për personin e punësuar, i cili kryen në këtë subjekt një procedurë pune, që lidhet drejtpërdrejt me armët, dokumentet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d”, të pikës 3, të kreut II, dëshminë e aftësisë teorik e praktik për përdorimin e armës, si dhe trajnimet specifike, sipas pozicionit të punës së punonjësit;

7.2 Dokumentet e përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 7, të këtij kreu, dëshmia e aftësisë teorik dhe praktik për përdorimin e armës, si dhe trajnimet specifike të punonjësit duhet të dorëzohen edhe fizikisht me postë në komisaratin e policisë, ku ka vendin e ushtrimit të aktivitetit ose selinë qendrore subjekti, i cili kërkon të pajiset me licencë për veprimtaritë e lejuara me armët, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i dorëzimit në formë elektronike të tyre.

7.3 Për rastet e kërkesave për ripërtëritje të licencës bëhet rivlerësimi i besueshmërisë së titullarit të licencës, ortakut/aksionarit të tij dhe i drejtuesit teknik të subjektit, si dhe vlerësimi i performancës dhe i ligjshmërisë së aktivitetit të subjektit gjatë periudhës së mëparshme të licencimit.

8. Afati i përgjithshëm i procedurës për miratimin/refuzimin e licencës është 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e kërkesës.

9. Afati i vlefshmërisë së licencës është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Me mbarimin e afatit të vlefshmërisë së saj, subjektit i lind e drejta të pajiset me licencë të re, duke dorëzuar

dokumentacionin përkatës të lartpërmendur në pikën 7, të kreut III, që provon përmbushjen e kriterëve të licencimit.”.

4. Pas pikës 9, të kreut III, shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

“9/1. Mosparaqitja e kërkesës për ripërtëritjen e licencës brenda afatit 90-ditor para përfundimit të afatit të licencës që ka në përdorim personi fizik/juridik sjell mosripërtëritjen e saj, si dhe pezullimin e aktivitetit të subjektit.

E drejta e subjektit për kërkesë për pajisjen me licencë të re nuk humbet.”.

5. Kreu IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

“IV. KRITERET E VEÇANTA TË LICENCIMIT

10. Krahas kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, subjekti plotëson edhe këto kriterë të veçanta për ushtrimin e veprimtarisë së lejuar me armë:

a) Për ushtrimin e veprimtarisë së importit dhe të tregtimit të armëve, të kategorisë “C” (gjahu) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit, sipas kushteve të miratuara me vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve’”, të ndryshuar, dhe në pronësi apo përdorim për 5 (pesë) vitet në vazhdim;

b) Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të armëve, të pjesëve kryesore dhe të municioneve të tyre të zotërojnë automjete, sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve’”, të ndryshuar;

c) Për ushtrimin e veprimtarisë për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatël, ndërtimi dhe mënyra e funksionimit të ambienteve, të plotësojnë kushtet e sigurisë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në pronësi apo përdorim për 5 (pesë) vitet në vazhdim;

ç) Për ushtrimin e veprimtarisë për aftësimin teorik e praktik të personave për përdorimin e armës, të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit, në pronësi apo në përdorim për 5 (pesë) vitet në vazhdim dhe poligon civil qitjeje, sipas kushteve të përcaktuara në vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve’”, të ndryshuar;

d) Për ushtrimin e veprimtarisë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil, të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit në pronësi apo përdorim për 5 (pesë) vitet në vazhdim dhe poligon civil qitjeje. Standardet dhe teknikat e çaktivizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

6. Kreu V ndryshohet, si më poshtë vijon:

“V. PROCEDURA TË PËRGJITHSHME DHE PROCEDURA TË PEZULLIMIT DHE TË SHFUQIZIMIT”

11. Zyrat e përfaqësimit të subjekteve që kryejnë veprimtari me armët e zjarrit, të cilat nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së subjektit dhe mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të tij, nuk është e detyrueshme që të kenë ambiente ose kushte të caktuara sigurie për ruajtjen e armëve, me përjashtim rasteve kur disponojnë mostra fizike të armëve, në proporcionalitet me sasinë dhe rrezikshmërinë e tyre. Degët e subjekteve të huaja ose shqiptare, që ushtrojnë aktivitete tregtare me armët, duhet të plotësojnë të njëjtat kushte sigurie dhe teknike në ambientet e punës e të ruajtjes së armëve.

12. Personi fizik ose juridik, ortakët/aksionarët, nëse ka, si dhe drejtuesi teknik për veprimtari të lejuara me armët, nuk mund të jenë njëkohësisht punonjës të Policisë së Shtetit apo të strukturave të

tjera me gradë të Ministrisë së Brendshme, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit apo punonjës të Policisë së Burgjeve.

13. Licenca e subjektit dhe certifikata e drejtuesit teknik për veprimtaritë e lejuara me armët lëshohet me vendim të Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim (KSHKCL), në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

14. Subjekti, brenda afatit 5-vjeçar nga koha e marrjes së licencës, mund të kryejë ndryshime në licencë lidhur me administratorin, ortakun/aksionarin dhe drejtuesin teknik. Në rast të ndryshimit të të dhënave të subjektit të pajisur me licencë për veprimtarinë e lejuar me armët, personi fizik ose juridik kryen ndryshimet në regjistrin tregtar që administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe njofton brenda 10 (dhjetë) ditëve strukturat e Policisë së Shtetit. Për ndryshimet në të dhënat e licencës, kur sjellin ndryshim të titullarit të licencës, ky i fundit dorëzon në formë elektronike dokumentacionin e nevojshëm sipas llojit të licencës. Procedura për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për licencim nga strukturat përkatëse të policisë, për titullarin e ri të licencës, është e njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 4, të kreut III, të këtij vendimi.

15. Personit, të cilit i është hequr licenca për veprimtaritë e lejuara me armët, i lind e drejta që të paraqesë kërkesë për pajisje me licencë të re pas kalimit të afatit trevjeçar.

16. Personit, të cilit i është hequr certifikata për drejtues teknik për veprimtaritë e lejuara me armët, i lind e drejta që të paraqesë kërkesë për pajisje me certifikatë të re pas kalimit të afatit dyvjeçar.

17. Drejtuesi teknik e ushtron aktivitetin vetëm në një subjekt të licencuar për veprimtaritë e lejuara me armët.

18. Licenca shfuqizohet në këto raste:

- a) me kërkesë të titullarit;
- b) për mospagim të taksës/tarifës përkatëse (nëse ka);
- c) në rast moszbatimi të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
- ç) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi;
- d) kur rrethanat janë të tilla që s'do të kishte kuptim ose mundësi për ripërmblidhjen e kushteve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm të pezullimit.

18.1 Komisioni merr vendimin për shfuqizimin e licencës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përcaktimi i shkaqeve të shfuqizimit.

18.2 Konstatimi i mosplotësisë së kriterëve apo të shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit pas ndodhjes së faktit.

18.3 Në rastin e shfuqizimit të licencës, taksa/tarifa e paguar nuk kthehet.

18.4 Në rast të ndryshimit faktik të të dhënave të përcaktuara në licencë, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e përgjithshme ose të veçanta të licencimit, ky ndryshim, pavarësisht se mund të cenojë apo jo këto kriteret, duhet t'i njoftohet, nga titullari i licencës, menjëherë strukturës përgjegjëse në Policinë e Shtetit, e cila bën vlerësimin e tyre. Kërkesa shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re, sipas së njëjtës kategori, për të cilën është bërë kërkesa për vetë licencën. Kur vlerësohet se ndryshimet e ndodhura nuk cenojnë kriteret, titullari i licencës pajiset me titullin e ndryshuar, afati i vlefshmërisë së të cilit mbaron në të njëjtën datë me atë të titullit të mëparshëm. Kur vlerësohet se ndryshimet e ndodhura cenojnë kriteret, licenca shfuqizohet. Përpara marrjes së vendimit të shfuqizimit, organi kompetent, urdhëron ripërmblidhjen e kriterëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrat për ripërmblidhjen e kriterëve.

18.5 Pika 18.4 nuk zbatohet në rast moszbatimi të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit dhe në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtim të interesit publik.

19. Pezullimi i licencës vendoset në këto raste:

a) Kur titullari humbet kriteret e licencimit të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) Kur konstatohet se titullari, në dokumentacionin e dorëzuar, ka paraqitur të dhëna të pasakta ose të rreme;

c) Me kërkesë të titullarit për të hequr dorë nga licenca;

ç) Kur titullari nuk përmbush, sipas ligjit, detyrimin për pagimin e gjobës së vënë si masë administrative.

19.1 Urdhri i pezullimit shfuqizohet nga organi përgjegjës, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

20. Në rastet e ndryshimit të kriterëve të përgjithshme ose të veçanta të licencimit, për shkak të ligjit, titullari i licencës vazhdon të ushtrojë veprimtarinë për të cilën është lëshuar licenca deri në përfundimin e afatit të përcaktuar. Pas përfundimit të afatit të licencës, subjekti paraqet kërkesë për licencë të re, sipas kriterëve të reja të përcaktuara me ligj apo me akte nënligjore.

21. Formati i licencave për veprimtaritë e lejuara më armë është sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

7. Pas kreut V shtohet kreu VI, me këtë përmbajtje:

“TË FUNDIT

22. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

SHTOJCA NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

L I C E N C Ë

PËR AFTËSIMIN TEORIK DHE PRAKTIK TË PERSONAVE PËR ARMËN

SUBJEKTI: _____

Nr. Licencës: _____

Nr. NUIS: _____

Data e Licencës ____ . ____ . ____

Adresa: _____

Në zbatim të ligjit 74/2014 "Për armët", të ndryshuar, VKM nr. 275, datë 01.04.2015 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve", VKM Nr. 421, datë 13.05.2015 "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët",

Komisioni pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Subjekti: _____ dhe vlerësoi përputhshmërinë me kriteret dhe kërkesat e ligjit,

VENDOSI:

Të miratojë dhënien e Licencës të ushtrimit të veprimtarisë "Për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën", Subjektit : _____.

Afati i Licencës është 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit, me të drejtë ripërtëritje.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

L I C E N C Ë

**PËR TRANSPORTIN E ARMËVE, PJESËVE KRYESORE
DHE MUNICIONEVE TË TYRE**

SUBJEKTI: _____

Nr. Licencës: _____

Nr. NUIS: _____

Data e Licencës ____ . ____ . ____

Adresa: _____

Në zbatim të ligjit 74/2014 "Për armët", të ndryshuar, VKM nr. 275, datë 01.04.2015 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve", VKM Nr. 421, datë 13.05.2015 "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët",

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Subjekti: _____ dhe vlerësoi se është në përputhje me kërkesat e ligjit,

VENDOSI:

Të miratojë dhënien e Licencës të ushtrimit të veprimtarisë "Për Transportin e Armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre", Subjektit : _____.

Afati i Licencës është 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit, me të drejtë ripërtëritje.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

L I C E N C Ë

PËR POLIGON CIVIL QITJE TË HAPUR, TË MBYLLUR, ME PJATEL

SUBJEKTI: _____

Nr. Licencës:

Nr. NUIS: _____

Data e Licencës ____ . ____ . ____

Adresa: _____

Në zbatim të ligjit 74/2014 "Për armët", të ndryshuar, VKM nr. 275, datë 01.04.2015 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve", VKM Nr. 421, datë 13.05.2015 "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët",

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Subjekti: _____ dhe vlerësoi se është në përputhje me kërkesat e ligjit,

VENDOSI:

Të miratojë dhënien e Licencës të ushtrimit të veprimtarisë "Për poligon civil qitje të hapur, të mbyllur, me pjatel", Subjektit : _____.

Afati i Licencës është 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit, me të drejtë ripërtëritje.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

L I C E N C Ë

PËR ÇAKTIVIZIMIN E ARMËVE TË ZJARRIT PËR PËRDORIMI CIVIL

SUBJEKTI: _____

Nr. Licencës: _____

Nr. NUIS: _____

Data e Licencës ____ . ____ . ____

Adresa: _____

Në zbatim të ligjit 74/2014 "Për armët", të ndryshuar, VKM nr. 275, datë 01.04.2015 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve", VKM Nr. 421, datë 13.05.2015 "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët",

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Subjekti: _____ dhe vlerësoi se është në përputhje me kërkesat e ligjit,

VENDOSI:

Të miratojë dhënien e Licencës të ushtrimit të veprimtarisë "Për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil", Subjektit : _____

Afati i Licencës është 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit, me të drejtë ripërtëritje.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

L I C E N C Ë

**PËR IMPORT DHE TREGTIM TË ARMËVE TË KATEGORISË "C" (GJAHUT) DHE
"D" (SPORTIVE), PJESËVE KRYESORE DHE MUNICIONEVE TË TYRE**

SUBJEKTI: _____

Nr. Licencës: _____

Nr. NUIS: _____

Data e Licencës ____ . ____ . ____

Adresa: _____

Në zbatim të ligjit 74/2014 "Për armët", të ndryshuar, VKM nr. 275, datë 01.04.2015
"Për miratimin e rregullores për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve", VKM Nr.
421, datë 13.05.2015 "Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet
e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët",

Komisioni pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Subjekti:
_____ dhe vlerësoi se është në përputhje me kërkesat e ligjit,

VENDOSI:

Të miratojë dhënien e Licencës të ushtrimit të veprimtarisë "Për import dhe tregtim të
Armëve të kategorisë "C" (gjahu) dhe "D" (sportive), pjesëve kryesore dhe
municioneve të tyre, Subjektit : _____.

Afati i Licencës është 5 (pesë) vjet nga data e lëshimit, me të drejtë ripërtëritje.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT